



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.250/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyndi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi lidhur me ankesën e Koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Mitrovicë, dhe subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Mitrovicë, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 3,300.00 (*tremijë e treqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.06.2017, përmes dërgesës postare, ndërsa sipas datës 12.06.2017 e protokolluar me nr.250/2017, me të cilën pretendon se me datën 08.06.2017, rrëth orës 8:30, në rrugën “Afrim Zhitija”, p.n., në objektin e Administratës Pensionale, në Mitrovicë, aktivistët nga radhi e subjektit politik LVV kanë vendosur posterat e kandidatit të tyre për deputet të Kuvendit të Kosovës.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës ligjore i Nenit 33 paragrafi 1 pika b e LZP-së. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur pesë fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Koalicioni PDK-AAK-NISMA dega në Mitrovicë, me nr. 250/2017 të datës 12.06.2017, ka paraqitur kërkësë për tërheqje të ankesës Anr.250/2017, të parashtruar kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje LVV dega në Mitrovicë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të ankesës gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Paneli vlerëson nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padishimtë rezulton se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në objekte publike, veprim që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), i LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e vlerësuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik, është shkelur nen 33, pika b), i LZP-së, pasi që posteret e kandidateve për deputet nga subjekti në fjalë, janë vendosur në ngjitur në objekte publike .

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga subjekti politik LVV, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në objektin e Administratës Pensionale të Kosovës, pra në objekt publik .

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, me nr.250/17 të datës 12.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.250/2017 të datës 12.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik LVV, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është ne interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njërsë prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në mbështetje të nenit 54 par.1 i Ligjit për Procedurën Administratave është parashikuar që “*Tërheqja e njërsë prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligor të palëve të tjera në procedim*”. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuar interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) i LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 250/2017 i datës 13.06.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi

*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi  
nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.  
4 të LZP-së.*